

**POLITIKA
MBI PËRDORIMIN E LOGOS SË DAK, SIMBOLIT TË
AKREDITIMIT DHE REFERENCËN TEKSTUALE NDAJ
AKREDITIMIT
DAK-PO-04**

**APROVUAR NGA,
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Irfan LIPOVICA**

PËRMBAJTJA

1. FUSHA	3
2. REFERENCAT	3
3. PËRGJEGJËSITË	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat	3
5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS	4
5.1 Logoja e DAK	4
5.2 Simboli i Akreditimit i DAK	4
5.3 Përshkrimi i simbolit të akreditimit	5
5.3.1 Simboli i Akreditimit për Laboratorët e Testimit	5
5.3.2 Simboli i Akreditimit për Laboratorët e Kalibrimit	5
5.3.3 2 Simboli i Akreditimit për Trupat Inspektues	5
5.3.4 Simboli i Akreditimit për Trupat Certifikues	6
5.3.5 Simbol i Akreditimit për TVK-të që kanë akreditim të shumëfishtë	6
5.4 Përdorimi i simbolit të akreditimit nga TVK	6
5.5 Referenca ndaj akreditimit	7
5.6 Përgjegjësia dhe shkeljet për keqpërdorimin e logos së DAK, simbolit të akreditimit apo referencës tekstuale ndaj akreditimit	8
6. ANEKSET	8
7. REGJISTRAT	8
8. HISTORIA	8

1. FUSHA

Kjo politikë përcakton rregullat e përgjithshme për përdorimin e logos së DAK-së, simbolin e akreditimit dhe referencën tekstuale ndaj akreditimit.

2. REFERENCAT

- a) Ligji Nr. 05/L-117 për Akreditimin;
- b) Udhëzimi Administrativ Nr.04/2019 për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të logos së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës, simbolin e akreditimit dhe referencën tekstuale ndaj akreditimit;
- c) ISO/IEC 17011:2017 Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për trupat e akreditimit që akreditojnë organet e vlerësimit të konformitetit;
- d) EA-3/01M:2025 - Kushtet e EA për përdorimin e simboleve të akreditimit, referencat tekstuale ndaj akreditimit dhe referenca ndaj statusit nënshkrues të EA MLA;
- e) ILAC P8:11/2023 Marrëveshja (Aranzhimi) e Njohjes Reciproke ILAC: Kërkesat Plotësuese dhe Udhëzimet për Përdorimin e Simboleve të Akreditimit dhe për Pretendimet e Statusit të Akreditimit nga Laboratorët e Akredituar dhe Trupat e Inspektimit.

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo politikë vlen për të gjitha TVK-të e DAK-së (të akredituara nga DAK dhe aplikuesi) dhe personeli i DAK-së të përfshirë në akreditim.

4. FJALORI DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalori

Për qëllimin e kësaj Politike zbatohen termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

TVK	Trupi për Vlerësimin e Konformitetit
DAK	Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës
V	Vlerësuesit
KP	Këshilli Profesional
KA	Këshilli i Akreditimit
KT	Komitetet Teknike

5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS

5.1 Logoja e DAK

Dizajni, forma, përmbajtja dhe përdorimi i logos së DAK-së rregullohen me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2019. Logoja e DAK-së ka një formë drejtkëndëshe 30 mm të gjerë dhe 17 mm të lartë siç është paraqitur më poshtë.



Logoja e akreditimit është me ngjyra, ku shkronjat "DAK" janë të përgatitura sipas kombinimit të mëposhtëm të ngjyrave: blu (duke përdorur kodin # 264E9F, i cili përmban kombinimin e mëposhtëm të ngjyrave: 38% e kuqe, 78% e gjelbër, 159% blu), ndërsa shenja e verdhë e artë në shkronjën "A" siç shfaqet në logo (duke përdorur kodin # D2A84F, i cili përmban kombinimin e mëposhtëm të ngjyrave: 210% e kuqe, 168% e gjelbër dhe 79% blu). Shkronjat më poshtë në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze shkruhen me shkronja të mëdha të zeza me *font*-in (germat) Calibri.



Logoja e akreditimit mund të përdoret gjithashtu në formë të zezë & bardhë, ku përgatitet sipas kombinimit të mëposhtëm të ngjyrave: e zezë (kodi # 000000) dhe e bardhë (kodi ## FFFFFFFF).

1. DAK përdor logon e saj si më poshtë:

- në të gjithë dokumentacionin e sistemit të menaxhimit të DAK, përfshirë certifikatat e akreditimit;
- në materialet promocionale;
- në të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara, përfshirë komunikimet përmes email-ave zyrtarë.
- DAK mund të përdor logon e saj në madhësi të tjera në varësi të dokumenteve; në raste të tilla, proporcionet midis elementeve të ndryshëm të logos duhet të ruhen.

2. Logoja e DAK-së përdoret ekskluzivisht nga DAK dhe përdoret për identifikimin e saj.

3. Përdorimi i logos së DAK-së nga kushdo tjetër është rreptësisht i ndaluar, përveç nëse autorizohet shprehimisht me shkrim nga DAK.

5.2 Simboli i Akreditimit i DAK

Politika e DAK-së **obligon përdorimin e detyrueshëm** të simbolit të akreditimit nga TVK-të e akredituara dhe u rekomandon fuqishëm TVK-ve të akredituara t'i referohen statusit të akreditimit në raportet e tyre drejt klientëve të tyre.

Dizajni, forma, përmbajtja dhe përdorimi i simbolit të akreditimit të DAK-së rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2019.

Simboli i akreditimit përfshin logon e DAK-së dhe një tregues të qartë se me cilin aktivitet vlerësimi të konformitetit (skemë të akreditimit) lidhet akreditimi. Simboli i akreditimit tregon që një TVK është kompetent në përputhje me standardin përkatës të akreditimit.

DAK dërgon simbolin e akreditimit tek TVK-të e akredituara. **TVK-të e akredituara obligohen** të përdorin simbolin e akreditimit për të dëshmuar se janë të akredituara në raportet dhe certifikatat e tyre.

Në rast se në raportin/certifikatën testet e mbulimit/kalibrimet/rezultatet e inspektimeve të cilat janë të akredituara dhe jo të akredituara, ato që nuk janë të mbuluara nga akreditimi do të shënjohen me * dhe duhet të shkruhet sa vijon: *"Testet / kalibrimet / inspektimet e shënjura me * NUK janë të mbuluara nga akreditimi i DAK-së. Për detaje të mëtejshme, ju lutemi kërkonit certifikatën e akreditimit në DAK."*

5.3 Përshkrimi i simbolit të akreditimit

Simboli i akreditimit përfshin: logon e DAK pa tekstin "Drejtoria e Akreditimit e Kosovës" në tri gjuhë, lloji i trupit nëse është fjala për testim (TESTIM), kalibrim (KALIBRIM), inspektim (INSPEKTIM), ose certifikim (CERTIFIKIM), një shkronjë e cila bën dallimin nëse është një laborator testues (L), laborator kalibrimi (K), trup inspektimi (I), ose trup certifikues (C), dhe numrin unik të TVK -së të akredituar të shprehur në tri (3) shifra.

Madhësia e simbolit të akreditimit në mm është 30 x 18 mm dhe do të përdoret vetëm siç është siguruar nga DAK.

DAK u siguron TVK-ve një simbol akreditimi për secilin standard (skemë) të akreditimit si më poshtë:


5.3.1 Simboli i Akreditimit për Laboratorët e Testimit



5.3.2 Simboli i Akreditimit për Laboratorët e Kalibrimit



5.3.3 2 Simboli i Akreditimit për Trupat Inspektues



5.3.4 Simboli i Akreditimit për Trupat Certifikues



5.3.5 Simbol i Akreditimit për TVK-të që kanë akreditim të shumëfishtë

Në rast se TVK ka akreditim për më shumë se një skemë të akreditimit, simboli i akreditimit do të përfshijë të gjithë informacionet e shprehura në paragrafët 3.3.1 - 3.3.4, p.sh. TVK që është akredituar kundrejt EN ISO/IEC 17025 për testim dhe kundrejt EN ISO/IEC 17020 për inspektim, simboli i akreditimit duket si më poshtë:



5.4 Përdorimi i simbolit të akreditimit nga TVK

DAK i dërgon në mënyrë elektronike simbolin e akreditimit secilit TVK të akredituar.

Simboli i akreditimit i DAK do të përdoret:

- nga TVK i akredituar derisa akreditimi të jetë akoma i vlefshëm;
- vetëm për fushat e aplikimit për të cilat TVK është akredituar.

Simboli i akreditimit duhet të vendoset në krye të faqes së parë në anën e djathtë ose në secilën faqe të raportit ose certifikatës. Në materialet promocionale, simboli i akreditimit duhet të vendoset një herë në secilin material ku bëhet referenca ndaj akreditimit.

Simboli i akreditimit duhet të vendoset në madhësi, format dhe ngjyrat e përcaktuara në këtë dokument. Në raporte ose letra që shoqërojnë raportet ose certifikatat, simboli mund të jetë në të zezë dhe të bardhë.

Simboli i akreditimit nuk mund të jetë më i madh se logoja ose simboli i TVK të akredituar.

Simboli DAK i akreditimit nuk mund të përdoret nga:

- aplikuesi për akreditim;
- TVK të cilave certifikatat e akreditimit u kanë skaduar;
- nënkontraktuesit e TVK-ve të akredituara;
- klientët e TVK-ve të akredituara;
- TVK-të gjatë periudhës së pezullimit të akreditimit.

Simboli DAK i akreditimit nuk mund të përdoret në:

- produktet ose artikujt të cilat testohen, kalibrohen, certifikohen ose inspektohen nga një organ i akredituar;

- paketim;
- karta e biznesit të personelit të TVK të akredituar;
- materiale promovuese të cilat promovojnë vlerësimin e konformitetit ose aktivitetet të tjera që nuk janë të akredituara;
- raporte ose certifikata që përmbajnë rezultatet e testeve/kalibrimeve, certifikimeve ose inspektimeve që nuk mbulohen nga fushëveprimi i akreditimit;
- raporte ose certifikata që përmbajnë rezultatet e testit, kalibrimit, certifikimit ose inspektimit për të cilat statusi i akreditimit është pezulluar për sa kohë që pezullimi është valid;
- raporte ose certifikata që përmbajnë rezultatet e testit, kalibrimit, certifikimit ose inspektimit për të cilat statusi i akreditimit është tërhequr.

Kur TVK kryen aktivitet jashtë fushëveprimit të akreditimit, rezultatet e një aktiviteti të tillë duhet të jenë në një raport të veçantë, i cili nuk mbartë simbolin e akreditimit ose të shënuar me një yll, dhe pastaj të sqarojë që metoda nuk është e akredituar.

Rezultatet e testeve/kalibrimeve/certifikimeve/inspektimeve të lëshuara nga nënkontraktori i cili është i akredituar ose jo nga DAK ose një organ tjetër akreditues nuk duhet të jenë në tekstin e raporteve/certifikatave të lëshuara nga laboratorit i akredituar nënkontraktues.

Simboli i akreditimit i vendosur në raportin ose certifikatën e testit/kalibrimit/certifikimit/inspektimit, nuk do të thotë që DAK pranon përgjegjësinë për saktësinë e rezultateve të testit, kalibrimit ose inspektimit ose vendimeve të certifikimit të mbuluara nga akreditimi.

DAK kërkon nga TVK-të e akredituara dhe monitoron gjatë proceseve të vëzhgimit që ata:

- a) janë në konformitet të plotë me kërkesat e DAK-së për pretendimin e statusit të akreditimit kur i referohen akreditimit në mediat e komunikimit,
- b) të mos bëhet ndonjë deklaratë çorientuese ose e paautorizuar në lidhje me akreditimin,
- c) të mos i referohen akreditimit në një mënyrë që të nënkuptojë që një produkt, proces, shërbim, menaxhim ose persona është aprovuar nga DAK.

DAK kërkon nga TVK të e akredituara

- a) pas tërheqjes së akreditimit, ndërprerjen e përdorimit të simbolit të akreditimit ose bërjen e ndonjë reference ndaj akreditimit,
- b) të informojnë klientët e tyre të prekur për pezullimin, reduktimin ose tërheqjen e akreditimit dhe pasojat shoqëruese pa vonesë të panevojshme.

5.5 Referenca ndaj akreditimit

Për referencë ndaj akreditimit, TVK-të e akredituara duhet të zbatojnë të njëjtat kushte dhe rregulla, si për simbolin e akreditimit.

TVK-të e akredituara nuk mund të përdorin simbolin e akreditimit dhe referencën ndaj akreditimit në të njëjtin dokument.

TVK-të e akredituara mund të bëjnë referencë ndaj akreditimit sipas deklaratës: *"TVK është akredituar nga DAK me numër të akreditimit për aktivitetin / standardin"*.

5.6 Përgjegjësia dhe shkeljet për keqpërdorimin e logos së DAK, simbolit të akreditimit apo referencës tekstuale ndaj akreditimit

TVK-të e akredituara janë përgjegjëse për përdorimin e duhur të simbolit të akreditimit të DAK-së.

Në rastet e keqpërdorimit të logos së DAK-së (pjesë e simbolit të akreditimit), simbolit të akreditimit ose referencës tekstuale ndaj akreditimit nga TVK-të e akredituar, DAK duhet të:

- informoj me shkrim TVK-në, ku kërkon që të ndërmarrë veprime të menjëhershme korrigjuese për përdorimin e simbolit të akreditimit,
- në rast se nuk ndërmerren veprimet korrigjuese, certifikata e akreditimit e TVK-së përkatëse pezullohet për 6 muaj,
- nëse pas pezullimit, TVK përdor gabimisht simbolin e akreditimit, atëherë DAK tërheq akreditimin e TVK-së.

Në rast se TVK nuk është akredituar (përfshirë akreditimet e të cilave kanë skaduar), DAK ka të drejtë të shqiptojë gjoba, në përputhje me Ligjin Nr. 05 / L-117.

Përdorimi i simboleve të rreme përbën një vepër penale të dënueshme sipas ligjit në fuqi.

6. ANEKSET

Nuk aplikohet

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohet

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrimi i ndryshimeve të aplikuara
02.12.2015	Ibush Luzha	Dokument i ri.
24.06.2016	Ibush Luzha	Artikulli 3.3, në korrelacion me UA Nr. 19/2012
12.11.2018	Banush Neziri	Ligji i Ri nr-05/L-117/2017 dhe A.O -02/2018 Urdhëresa Administrative
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 04/2019
25.02.2026	Valmira Sejdiu	Rishikim i pjesshëm në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 04/2019